



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria -Vlada - Government**

*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,  
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural  
Development*

Duke u bazuar në nenin 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenin 22, 23, 24 paragrafi 24.1 pika (a), (i) dhe paragrafi 24.2 të Ligjit Nr. 02/L-95 për Mbrojtjen e Bimëve të dt. 31 janar 2008, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,  
Nxjerr sa vijon:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.20/2008**

**Për krijimin e regjistrit të prodhuesve, importuesve, eksportuesve, deponuesve dhe shpërndarësve të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1.1 Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen kushtet e regjistrimit për personat fizik dhe juridik që merren me prodhimin, importimin, eksportimin, deponimin dhe shpërndarjen e bimëve dhe objekteve tjera të përcaktuara sipas Listave V.A dhe V.B prodhuesit e llojeve specifike të bimëve si dhe caktimin e përmbajtjes dhe mënyrën e mbajtjes së të dhënave në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

1.2 Personat që ushtrojnë veprimtarinë nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të paraqesin kërkesë me shkrim për tu regjistruar në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Departamentin e Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve – Njësia për mbrojtjen e bimëve.

**Neni 2**

2.1 Askush nuk mund të prodhoj, importoj, eksportoj, deponoj dhe shpërndaj produkte bimore nëse nuk është i regjistruar dhe licencuar sipas këtij udhëzimi administrativ.

2.2 Personi për tu licencuar si prodhues, përpunues, importues, deponues dhe shpërndarës i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera në kërkesën për regjistrim duhet të bashkëngjisin dokumentacionit të dhënat:

- a) emri dhe adresa e personit fizik apo juridik;
- b) lloji i veprimtarisë që ushtron;

- c) dëshmitë mbi aftësitë profesionale të personave me përgatitje të mesme profesionale bujqësore;
- d) adresa e plotë e vendit ku ushtrohet veprimtaria;
- e) llojin e bimëve apo produkteve bimore më të cilat merret;
- f) dëshminë për origjinën e bimëve dhe produkteve bimore në rastet kur ato importohen;
- g) certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- h) telefoni, faksi apo e-maili.

### **Neni 3** **Kërkesa për regjistrim**

Nëse janë plotësuar kushtet sipas Ligjit Nr. 02/L-95 për mbrojtjen e bimëve dhe sipas nenit 2 të këtij udhëzimi administrativ personat e regjistruar në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të pajisen me numër të identifikimit.

### **Neni 4** **Refuzimi**

4.1 Nëse organi kompetent konstaton se subjekti nuk i ka plotësuar kushtet për regjistrim dhe nuk ka kompletuar dokumentacionin e nevojshëm, atëherë jepet afat prej 8 ditësh për kompletim të dokumentacionit.

4.2 Nëse subjekti nuk arrin ta bëjë kompletimin e dokumentacionit në afatin shtesë nga paragrafi 1 i këtij neni, kërkesa refuzohet.

### **Neni 5** **Anulimi i regjistrimit**

Regjistrimi mund të pezullohet apo anulohet nëse subjekti vepron në kundërshtim me këtë udhëzim administrativ.

### **Neni 6** **Mbajtja e regjistrit**

Personi i regjistruar sipas neni 1 të këtij udhëzimi administrativ, duhet që çdo herë të mbaj evidencën në librin e regjistrimit për prodhimin, importimin, eksportimin dhe deponimin e bimëve dhe produkteve bimore.

### **Neni 7** **Inspektimi**

Personat që merren me prodhimin, importimin, eksportimin dhe deponimin e bimëve dhe produkteve bimore janë të obliguar që në çdo kohë dhe vend objekt apo mjet transportues t'ia afrojnë për rishikim inspektorit fitosanitar dokumentacionin e kërkuar dhe t'i mundësojnë atij qasje të lirshme në inspektim.

## **Neni 8**

8.1 Prodhimi, importimi eksportimi, deponimi dhe shpërndarja e bimëve dhe objekteve tjera sipas Listave V.A dhe V.B që nuk i përgjigjën kushteve të përcaktuara për regjistrim neni 2 të këtij udhëzimi administrativ do të konfiskohen.

8.2 Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ është Formulari nr.1.

## **Neni 9**

Moszbatimi i këtij udhëzimi administrativ sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara në nenin 66 paragrafi 66.1 pika (b) të Ligjit Nr.02/L-95 për mbrojtjen e bimëve.

## **Neni 10**

### **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më 31.03.2008

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministri,  
Idriz Vehapi

---